



PROGRAMET E TRAJNIMEVE, FORMIMIT
DHE CERTIFIKIMIT PROFESIONAL PRANË
UNIVERSITETIT MESDHETAR TË SHQIPËRISË

Hyrje

Misioni i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë është përgatitja e specialistëve dhe liderëve të spikatur për sektorin publik, privat dhe jofitimprurës dhe gjenerimi i ideve që u japin përgjigje dhe zgjidhje sfidave aktuale dhe perspektive të zhvillimit të vendit dhe rajonit.

Filozofia e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, është ndërtimi i një komuniteti, mësimi dhe krijimi në të cilin respektohet, vlerësohet dhe besohet çdo pjestar dhe zhvillohen pritshmëri të larta për veten dhe të tjerët, nëpërmjet inspirimit, arritjeve dhe ekselencës. Misioni i sipërpërmendur është konceptuar në harmoni të plotë me misionin e përgjithshëm të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, të shprehur në nenin 2, pika c të ligjit Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të përshtatur me standardet europiane¹, Kartën e Bolonjës, si dhe me veçantitë dhe risitë që synon të sjellë ky institucion në vendin tonë dhe më gjerë.

Për të përmbushur misionin dhe rolin që ka si institucion i arsimit të lartë, në dobi të shoqërisë, ku zhvillon aktivitetin e tij, UMSH, do të kryejë aktivitete të shumëllojshme në fushën e mësimdhënies, rritjes së cilësisë dhe standarteve të programeve të studimit të ofruara, përfshirë edhe programeve e trajnimeve profesionale si dhe aktiviteteve të formimit të vazhduar në profesione të rregulluara me ligj në Republikën e Shqipërisë. Këto do tu adresohen: studentëve, stafit akademik, të punësuarve ne sektorin publik e privat në vend, rajon etj.

¹ Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” Neni 2, pika c:”Të krijojë një sistem të unifikuar të arsimit të lartë, kërkimit shkencor në institucionet e arsimit të lartë, inovacionit bashkëkohor e konkurrues në hapësirën europiane të arsimit të lartë”.

Në mbështetje të “**Strategjisë Institucionale të Zhvillimit 2025–2032**”, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë përveç programeve tradicionale të cikleve të studimit do të zhvillojë edhe programe të shkurtra profesionale dhe certifikime të orientuara nga tregu, të cilat adresojnë nevoja emergjente të ekonomisë digjitale dhe të gjelbër. Fushat prioritare përfshijnë:

- ✦ *Vlerësimi dhe zhvillimi i pasurive të paluajtshme*
- ✦ *Turizëm i qëndrueshëm dhe menaxhim destinacionesh*
- ✦ *Teknologjia dhe inovacioni*
- ✦ *Siguria kibernetike dhe menaxhimi i rrezikut digjital*
- ✦ *Mjekësia dhe shëndeti publik*
- ✦ *Siguria në ambjentet e punës*
- ✦ *Psikologjia dhe çështjet sociale*
- ✦ *Kualifikime në fushën e së drejtës*
- ✦ *Edukimi dhe zhvillimi*
- ✦ *Projektet europiane dhe ndërkombëtare*
- ✦ *Kualifikime në fushën e ekonomisë*
- ✦ *Etj..*



Këto programe, rrisin punësueshmërinë dhe sigurojnë fleksibilitet në të nxënë gjatë gjithë jetës (lifelong learning). Integrimi i programeve dhe ndërlidhja ndërdisiplinore. Një nga shtyllat themelore të modelit akademik të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë është ndërtimi i një arkitekture kurrikulare të integruar dhe koherente. Kjo qasje synon të kapërcejë fragmentarizimin e dijes dhe të ofrojë një rrugëtim akademik të qartë dhe të vazhdueshëm për studentët, duke i hapur rrugën drejt arritjeve të ndryshme profesionale.

Për të realizuar këtë, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë zbaton një strategji të dyfishtë integrimi, e cila operon si në plan vertikal ashtu edhe në atë horizontal, në harmoni të plotë me parimet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA) dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (EQF).

Më poshtë do të paraqiten disa prej trajnimeve që zhvillohen në IAL.

<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Institucioni bashkëpunues</i>
1.	Ndërmjetës i pasurive të paluajtshme	Ministria e Drejtësisë
2.	Administrator falimenti	Ministria e Drejtësisë
3.	Prokurime publike	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, MEKI
4.	Programi i studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike	Ministria e Arsimit dhe Sportit
5.	Trajnim i akredituar nga ASCK për mjekë dhe infermierë “Burnout-i i personelit mjekësor dhe ndikimi i tij tek pacienti”	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
6.	Trajnim për edukimin në vazhdim,” Ndërmjetës në sigurime kategoria jetë dhe jo-jetë”.	Auroriteti i Mbikqyrjes Financiare
7.	Trajnim profesional “Cybersecurity”	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, MEKI
8.	Trajnim profesional “Data science & AI”	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, MEKI
9.	Trajnim profesional “Marketingu digjital”	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, MEKI
10.	Trajnim profesional “Python software development”	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, MEKI
11.	Trajnim profesional “Legjislacioni tatimor dhe administrimi fiskal në shqipëri”	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, MEKI
12.	Trajnim Profesional “Menaxhim projektsh”	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, MEKI

1. NDËRMJETËS I PASURIVE TË PALUAJTSHME

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është licensuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë me Nr. 214, dt.22.04.2024, si një nga Institucionet e Arsimit të Lartë në vendin tone për të zhvilluar: Programin e detyrueshëm të trajnimit për kandidatët për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme. Ky programi i përgatit kandidatët si specialistë të aftë për të vepruar në tregun imobiliar me njohuri të plota juridike, ekonomike dhe praktike. Ai përfshin modulën e vlerësimit të pronave, procedurat e shitblerjes, qirasë dhe këmbimit, si dhe aspektet e regjistrimit në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Kursantët njihen me legjislacionin përkatës, detyrimet tatimore, si dhe me rregullat e etikës profesionale. Programi përfshin trajnime në: Negocimi dhe komunikimi në pasuritë e paluajtshme; Legjislacioni mbi tatim-taksat; Njohuri rreth të drejtës civile dhe tregtare; Etika profesionale, ndërmjetësimi dhe profesionet e lira; Praktikë; Parimet themelore të vlerësimit të pronave, menaxhimit dhe mirëmbajtjes së tyre; Veprat penale ndaj pasurive të paluajtshme, krimi i organizuar dhe pastrimi i parave; Regjimi juridik i pasurive të paluajtshme; Hartim kontratash; Marketimi dhe shitja. Përmes rasteve praktike, pjesëmarrësit mësojnë të menaxhojnë marrëdhëniet ndërmjet palëve dhe të kryejnë ndërmjetësime transparente. Në përfundim, të këtij trajnimit zhvillohet testimi i cili kërkon që kandidatët të arrijnë të paktën 80% të pikëve me qëllim që të rezultojnë fitues. Pas kalimit të testimit pjesëmarrësit janë të përgatitur për të aplikuar për licencim pranë Ministrisë së Drejtësisë sipas kërkesave ligjore kombëtare. Ky program i detyrueshëm i trajnimit përveç mundësisë për tu licensuar si ndërmjetës ofron edhe një bazë të fortë për ndërtimin e një karriere të qëndrueshme në fushën e pasurive të paluajtshme.

2. ADMINISTRATOR FALIMENTI

Programi profesional i trajnimit për Administrator Falimenti synon të formojë ekspertë të kualifikuar në menaxhimin e subjekteve tregtare që përballen me vështirësi financiare. Kursi mbështetet në Legjislacioni vendas “Për Falimentimin dhe Riorganizimin e Shoqërive Tregtare”, duke ofruar njohuri teorike dhe praktike mbi procedurat e falimentit. Pjesëmarrësit mësojnë të administrojnë pasurinë e debitorëve, të bashkëpunojnë me kreditorët dhe gjykatat, si dhe të hartojnë plane të riorganizimit të qëndrueshëm. Programi trajton aspektet kontabël, ekonomike dhe juridike të falimentit, si dhe parimet e etikës dhe përgjegjësisë profesionale. Në fokus janë aftësitë për raportim, komunikim me palët dhe zgjidhje të konflikteve ligjore. Përmes studimeve të rasteve konkrete, kursantët fitojnë përvojë praktike mbi menaxhimin e krizave financiare. Në përfundim, ata janë të kualifikuar për të aplikuar për licencim si administratorë falimenti pranë Ministrisë së Drejtësisë.

3. PROKURIMET PUBLIKE

Ky kurs profesional përgatit ekspertë të kualifikuar në fushën e prokurimeve publike, në përputhje me Ligjin Nr. 162. Dt. 23.12.2020” Për prokurimin publik”, Ligjin Nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe aktet nënligjore përkatëse. Programi mbulon të gjithë ciklin e prokurimit: planifikimin, hartimin e dokumenteve të tenderit, publikimin në APP, vlerësimin e ofertave dhe ekzekutimin e kontratave. Pjesëmarrësit njihen me parimet e transparencës, konkurrencës dhe barazisë ligjore në proceset e prokurimit. Kursi trajton gjithashtu menaxhimin e fondeve publike, mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave dhe raportimin institucional. Përfshihet pjesa mbi konfliktin e interesit, etikën profesionale dhe parandalimin e korrupsionit në prokurime. Programi ndërthur leksionet teorike me ushtrime praktike bazuar në dokumentacion real tenderash. Në përfundim të trajnimit zhvillohet edhe testimi përkatës referuar moduleve të zhvilluara. Pjesëmarrësit do të

pajisen me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të punuar në administratën publike apo në sektorin privat. Kursi përfundon me certifikim të njohur nga: Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, trajnimi u ofron pjesëmarrësve mundësinë për të ndërtuar rrjete profesionale me ekspertë dhe kolegë nga institucione të ndryshme publike dhe private. Trajnimi synon të forcojë aftësitë vendimmarrëse dhe menaxheriale në proceset e prokurimit. Pjesëmarrësit mësojnë të identifikojnë rreziqet ligjore dhe financiare dhe të aplikojnë praktikatat më të mira për të siguruar eficiencë dhe transparencë. Përmes studimeve të rasteve reale dhe diskutimeve interaktive, pjesëmarrësit zhvillojnë aftësi praktike që mund të aplikohen menjëherë në punën e tyre.

4. PROGRAMI I STUDIMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR NË FUSHËN PSIKO-PEDAGOGJIKE

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është IAL e cila e ofron këtë program, miratuar me Urdhër Nr. 378, datë 14.07.2023, të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit në Republikën e Shqipërisë. Ky program është projektuar për individët që dëshirojnë të ushtrojnë profesionin e mësuesit, por nuk kanë një formim të plotë psiko-pedagogjik. Ai u drejtohet mësuesve aktualë pa formim të specializuar, si dhe të diplomuarve në fusha si Informatikë, Gjuhë, Shkenca Natyrore, Ekonomi, Sociologji apo Filozofi, që synojnë të hyjnë në sistemin arsimor. Programi zgjat 1 semestër dhe përmban 35 kredite ECTS, duke u zhvilluar me kohë të plotë. Programi zhvillohet nën drejtimin e Departamentit të Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave dhe Departamentit të Psikologjisë dhe Sociologjisë pranë Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane, në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë. Pjesëmarrësit fitojnë kompetenca në psikologjinë e edukimit, didaktikë, menaxhim klase dhe komunikim pedagogjik. Në përfundim, ata pajisen me Certifikatë për Formim Psiko-Pedagogjik, e lëshuar nga UMSH dhe e miratuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore. Programi është në përputhje me Nivelin 7

të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe siguron përgatitjen e duhur për ushtrimin ligjor të profesionit të mësuesit në arsimin parauniversitar.

5. TRAJNIM I AKREDITUAR NGA ASCK PËR MJEKË DHE INFERMIERË ME TITULL “BURNOUT-I I PERSONELIT MJEKËSOR DHE NDIKIMI I TIJ TEK PACIENTI”.

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror (ASCK) pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Republikën e Shqipërisë, në mbështetje dhe zbatim të VKM 788 Dt. 22.09.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, standardeve dhe procedurave të procesit të akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë”; ka miratuar me shkresën Nr.1280/1 Prot. Dt. 24.10.2025; kërkesën e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë për akreditimin e aktivitetit trajnues me titull “Burnout-i i personelit mjekësor dhe ndikimi i tij tek pacienti”. Ky aktivitet, i akredituar me 3 kredite për mjekët dhe infermierët, është pjesë e edukimit në vazhdim profesional dhe synon të trajtojë fenomenin e burnout-it te personeli shëndetësor dhe ndikimin e tij të drejtpërdrejtë në cilësinë e kujdesit ndaj pacientit. Trajnimi ofron njohuri teorike dhe praktike për identifikimin, parandalimin dhe menaxhimin e stresit profesional, duke përmirësuar mirëqenien e stafit dhe efektivitetin e shërbimeve shëndetësore. Pjesëmarrësit marrin certifikatë individuale me kreditet përkatëse, ndërsa lektorët dhe organizatorët vlerësohen me dyfishin e krediteve për rolin e tyre në aktivitet. Certifikatat përmbajnë shënimin se aktiviteti është i akredituar nga ASCK, dhe lista e pjesëmarrësve dhe vlerësimet dorëzohen pranë Agjencisë pas përfundimit të aktivitetit. Ky trajnim përfaqëson një mundësi të rëndësishme për mjekët dhe infermierët për të rritur aftësitë profesionale, për të menaxhuar stresin dhe për të kontribuar në përmirësimin e kujdesit ndaj pacientit në mënyrë të qëndrueshme dhe profesionale. Trajnimi zhvillohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë nën kujdesin e Drejtorisë së Edukimit në Vazhdim (ASCK) pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Republikën e Shqipërisë.

6. TRAJNIM PËR EDUKIMIN NË VAZHDIM,” NDËRMJETËS NË SIGURIME KATEGORIA JETË DHE JO-JETË”.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka njohur me Urdhër Nr. 1689/1 Prot. Dt. 14.10.2025, aktivitetet e edukimit në vazhdim të organizuara nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë për trajnimin e ndërmjetësve në sigurime, kategori agjentë për klasat jetë dhe jo-jetë, sipas Rregullores nr. 198, datë 29.12.2020 “Për kualifikimin profesional dhe edukimin në vazhdim”. Ky trajnim do të zhvillohet me ekspertë lektorë nga anëtarët e stafit akademik të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, përfshirë anëtarët me përvojë në finance, administrim dhe menaxhim, si dhe trajnerë të ftuar ku janë angazhuar disa nga specialistët më të përgatitur dhe me përvojë në fushën e sigurimeve në vendin tonë. Programi ka për qëllim të ofrojë njohuri të avancuara mbi produktet dhe procedurat e sigurimeve, standardet profesionale, ligjshmërinë dhe etikën në sektorin e sigurimeve, duke synuar zhvillimin profesional të qëndrueshëm të pjesëmarrësve. Pjesëmarrësit përfitojnë aftësi praktike dhe teorike të nevojshme për menaxhimin e situatave komplekse dhe për ofrimin e shërbimeve të sigurimeve jetë dhe jo-jetë me cilësi të lartë, rritjen e kompetencave profesionale dhe mundësinë për të aplikuar praktika të mira nga ekspertë të fushës së sigurimeve. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë e zhvillon këtë trajnim të edukimit në vazhdim me mbështetjen dhe nën monitorimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për të siguruar zbatimin e standardeve dhe kritereve rregullatore, duke garantuar që trajnimi i ndërmjetësve në sigurime të jetë në përputhje me praktikën më të mira profesionale dhe kërkesat ligjore të mbikëqyrjes financiare.

7. TRAJNIM PROFESIONAL “CYBERSECURITY”

Ky trajnim profesional përgatit ekspertë të kualifikuar në fushën e sigurisë kibernetike, duke ofruar njohuri të thelluara mbi mbrojtjen e infrastrukturave kritike, rrjeteve dhe sistemeve të informacionit. Programi përfshin realizimin e 20 orëve në total dhe mbulon

konceptet bazë dhe të avancuara të cybersecurity, përfshirë identifikimin e kërcënimeve, menaxhimin e rreziqeve, sigurinë e rrjetit, kriptografinë, parandalimin e sulmeve kibernetike dhe reagimin ndaj incidenteve. Pjesëmarrësit njihen me praktikatat më të mira të industrisë për mbrojtjen e të dhënave, sigurinë e informacionit në institucionet publike dhe kompanitë private, si dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare (ISO 27001, NIST, GDPR). Trajnimi përfshin gjithashtu etikën në sigurinë kibernetike, menaxhimin e konflikteve të interesit në kontekstin e sigurisë, dhe parandalimin e rreziqeve nga sulmet e brendshme dhe të jashtme. Programi i këtij trajnimit ndërthur leksionet teorike me ushtrime praktike, simulime të sulmeve kibernetike, analiza të rasteve reale dhe përdorimin e mjeteve profesionale të mbrojtjes kibernetike. Pjesëmarrësit zhvillojnë aftësi të aplikuara në identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve, përgjigjen ndaj incidenteve, dhe sigurimin e integritetit, konfidencialitetit dhe disponueshmërisë së informacionit. Në përfundim të trajnimit zhvillohet testimi përkatës referuar moduleve të zhvilluara, dhe pjesëmarrësit pajisen me certifikim të njohur nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve në Republikën e Shqipërisë. Trajnimi gjithashtu ofron mundësinë për të ndërtuar rrjete profesionale me ekspertë të fushës dhe kolegë nga sektori publik dhe privat, duke forcuar aftësitë vendimmarrëse dhe menaxheriale në fushën e sigurisë kibernetike.

8. TRAJNIM PROFESIONAL “DATA SCIENCE & AI”

Ky trajnim profesional përgatit ekspertë të kualifikuar në fushën e Data Science dhe Inteligjencës Artificiale, duke ofruar njohuri të thelluara mbi analizën e të dhënave, modelimin statistik, mësimin makinerik dhe aplikimet praktike të AI në sektorin publik dhe privat. Programi përfshin realizimin e 40 orëve në total dhe mbulon konceptet bazë dhe të avancuara të Data Science dhe AI, përfshirë pastrimin dhe përpunimin e të dhënave, vizualizimin e të dhënave, ndërtimin e modeleve parashikuese, analizën e të dhënave të mëdha (Big Data) dhe implementimin e algoritmeve të mësimin të makinerisë dhe inteligjencës artificiale. Pjesëmarrësit njihen me praktikatat më të mira të industrisë për

analizën dhe menaxhimin e të dhënave, etikën në përdorimin e inteligjencës artificiale, ruajtjen e privatësisë dhe sigurinë e informacionit sipas standardeve ndërkombëtare (ISO, GDPR, IEEEE). Trajnimi përfshin gjithashtu diskutimin e implikimeve ligjore, etike dhe sociale të përdorimit të AI dhe analizës së të dhënave, si dhe praktikatat për parandalimin e bias-it dhe rreziqeve të algoritmeve. Programi i këtij trajnimi ndërthur leksionet teorike me ushtrime praktike, analiza të të dhënave reale, projektim dhe testim të modeleve të AI, përdorimin e mjeteve dhe platformave profesionale si Python, R, TensorFlow, dhe bibliotekat e tjera të mësimit makinerik. Pjesëmarrësit zhvillojnë aftësi të aplikuara në krijimin e modeleve parashikuese, marrjen e vendimeve bazuar në të dhëna dhe optimizimin e proceseve me përdorimin e AI. Në përfundim të trajnimit zhvillohet testimi përkatës referuar moduleve të zhvilluara, dhe pjesëmarrësit pajisen me certifikim të njohur nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve në Republikën e Shqipërisë. Trajnimi gjithashtu ofron mundësinë për të ndërtuar rrjete profesionale me ekspertë të fushës dhe kolegë nga sektori publik dhe privat, duke forcuar aftësitë vendimmarrëse dhe menaxheriale në fushën e Data Science dhe Inteligjencës.

9. TRAJNIM PROFESIONAL “MARKETINGU DIGJITAL”

Ky trajnim profesional përgatit ekspertë të kualifikuar në fushën e Marketingut Digjital, duke ofruar njohuri të thelluara mbi strategjitë, mjetet dhe praktikatat më të mira për promovimin dhe zhvillimin e biznesit në kanalet online. Programi përfshin realizimin e 40 orëve në total dhe mbulon konceptet bazë dhe të avancuara të marketingut digjital, përfshirë marketingun në rrjetet sociale, optimizimin për motorët e kërkimit (SEO), marketingun përmes motorëve të kërkimit (SEM), email marketingun, marketingun përmes përmbajtjes, reklamimin online (PPC), analizën e të dhënave të marketingut dhe strategjitë e automatizimit të marketingut. Pjesëmarrësit njihen me praktikatat më të mira të industrisë për krijimin e fushatave digjitale efektive, matjen e performancës së kanaleve digjitale, etikën dhe rregulloret në marketingun online, si dhe ruajtjen e privatësisë dhe sigurinë e të dhënave sipas standardeve ndërkombëtare (GDPR, ISO, dhe praktikatat e

rekomanduara nga institucionet e marketingut digjital). Trajnimi përfshin gjithashtu analizën e trendëve digjitalë, përdorimin e platformave të menaxhimit të mediave sociale dhe strategjitë për rritjen e angazhimit të klientëve. Programi i këtij trajnimit ndërthur leksionet teorike me ushtrime praktike, analizë të fushatave reale digjitale, krijim dhe menaxhim të përmbajtjes digjitale, përdorimin e mjeteve dhe platformave profesionale si Google Analytics, Google Ads, Meta Business Suite, Mailchimp, HubSpot dhe software të tjera të marketingut digjital. Pjesëmarrësit zhvillojnë aftësi të aplikuara në krijimin dhe menaxhimin e fushatave digjitale, analizimin e performancës dhe optimizimin e strategjive të marketingut për rezultate maksimale. Në përfundim të trajnimit zhvillohet testimi përkatës referuar moduleve të zhvilluara, dhe pjesëmarrësit pajisen me certifikim të njohur nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve në Republikën e Shqipërisë. Trajnimi gjithashtu ofron mundësinë për të ndërtuar rrjete profesionale me ekspertë të fushës dhe kolegë nga sektori publik dhe privat, duke forcuar aftësitë vendimmarrëse dhe menaxheriale në fushën e Marketingut Digjital.

10. TRAJNIM PROFESIONAL “PYTHON SOFTWARE DEVELOPMENT”

Ky trajnim profesional përgatit ekspertë të kualifikuar në zhvillimin e softwerit duke përdorur gjuhën programuese Python, duke ofruar njohuri të thelluara mbi konceptet bazë dhe të avancuara të programimit, zhvillimin e aplikacioneve dhe automatizimin e proceseve në sektorin publik dhe privat. Programi përfshin realizimin e 20 orëve në total dhe mbulon tematika si strukturat e të dhënave, kontrolli i rrjedhës, funksionet dhe modulet, programimi objekt-orientuar, menaxhimi i paketave dhe bibliotekave, zhvillimi i aplikacioneve web dhe desktop, si dhe integrimi me bazat e të dhënave. Pjesëmarrësit njihen me praktikat më të mira të industrisë për zhvillimin e softuerit të qëndrueshëm dhe të sigurt, përdorimin e bibliotekave dhe framework-eve si Django, Flask, Pandas, NumPy, dhe praktikat e testimit dhe debugimit të aplikacioneve. Trajnimi përfshin gjithashtu etikën në zhvillimin e softuerit, sigurinë e kodit dhe menaxhimin e projekteve softuerike sipas standardeve ndërkombëtare. Programi i këtij trajnimit ndërthur leksionet

teorike me ushtrime praktike, zhvillim dhe testim të aplikacioneve reale, përdorimin e mjeteve dhe platformave profesionale për menaxhimin e kodit dhe projekteve (p.sh., Git, GitHub), si dhe implementimin e zgjidhjeve softuerike të aplikueshme menjëherë në punë. Pjesëmarrësit zhvillojnë aftësi praktike në krijimin e aplikacioneve, automatizimin e proceseve dhe zgjidhjen e problemeve të kompleksitetit të ndryshëm me Python. Në përfundim të trajnimit zhvillohet testimi përkatës referuar moduleve të zhvilluara, dhe pjesëmarrësit pajisen me certifikim të njohur nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve në Republikën e Shqipërisë. Trajnimi gjithashtu ofron mundësinë për të ndërtuar rrjete profesionale me ekspertë të fushës dhe kolegë nga sektori publik dhe privat, duke forcuar aftësitë vendimmarrëse dhe menaxheriale në zhvillimin e softuerit me Python.

11. TRAJNIM PROFESIONAL “LEGJISLACIONI TATIMOR DHE ADMINISTRIMI FISKAL NË SHQIPËRI”

Ky trajnim profesional përgatit ekspertë të kualifikuar në fushën e legjislacionit tatimor dhe administrimit fiskal, duke ofruar njohuri të thelluara mbi sistemin tatimor shqiptar, procedurat e administrimit të taksave dhe menaxhimin e detyrimeve fiskale për individë dhe biznese. Programi përfshin realizimin e 56 orëve në total dhe mbulon konceptet bazë dhe të avancuara të legjislacionit tatimor, përfshirë taksat mbi të ardhurat, tatimin mbi fitimin, TVSH-në, kontributet e sigurimeve shoqërore, taksat vendore, procedurat e deklarimit dhe pagesës, si dhe kontrollet dhe auditimet fiskale. Pjesëmarrësit njihen me praktikën më të mira të administrimit fiskal, interpretimin e ligjeve dhe udhëzimeve tatimore, etikën në menaxhimin e detyrimeve fiskale, parandalimin e evazionit dhe shmangies fiskale, si dhe ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit financiar. Trajnimi përfshin gjithashtu diskutimin e implikimeve ligjore dhe praktike të legjislacionit tatimor në sektorin publik dhe privat, si dhe zbatimin e praktikave të mira sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe administrimit fiskal. Programi i këtij trajnimi ndërthur leksionet teorike me ushtrime praktike, analizë të rasteve reale, përgatitje dhe kontroll të

deklaratave tatimore, përdorimin e mjeteve profesionale të menaxhimit fiskal dhe aplikacioneve softuerike për tatime dhe kontabilitet. Pjesëmarrësit zhvillojnë aftësi praktike në interpretimin e ligjit, planifikimin dhe ekzekutimin e detyrimeve fiskale, dhe menaxhimin e marrëdhënieve me autoritetet tatimore. Në përfundim të trajnimit zhvillohet testimi përkatës referuar moduleve të zhvilluara, dhe pjesëmarrësit pajisen me certifikim të njohur nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve në Republikën e Shqipërisë. Trajnimi gjithashtu ofron mundësinë për të ndërtuar rrjete profesionale me ekspertë të fushës dhe kolegë nga sektori publik dhe privat, duke forcuar aftësitë vendimmarrëse dhe menaxheriale në administrimin fiskal dhe zbatimin e legjislacionit tatimor në Shqipëri.

12. TRAJNIM PROFESIONAL “MENAXHIM DHE SHKRIM PROJEKTESH”

Ky trajnim profesional përgatit ekspertë të kualifikuar në fushën e menaxhimit dhe shkrimit të projekteve, duke ofruar njohuri të thelluara teorike dhe praktike mbi ciklin e plotë të projektit- nga ideimi dhe planifikimi, deri te implementimi, monitorimi dhe vlerësimi i tij. Programi përfshin 40 orë mësimore dhe synon të zhvillojë aftësitë profesionale për hartimin e projekteve të suksesshme në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të menaxhimit të projekteve. Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit njihen me konceptet bazë të menaxhimit të projektit, përfshirë analizën e nevojave, hartimin e objektivave SMART, ndërtimin e Logical Framework, planifikimin e aktiviteteve dhe burimeve, hartimin e buxhetit, si dhe menaxhimin e riskut. Një vëmendje e veçantë i kushtohet hartimit të projekteve për financime vendore dhe ndërkombëtare, përfshirë fondet e Bashkimit Evropian, organizatat ndërkombëtare dhe donatorët publikë e privatë. Trajnimi mbulon gjithashtu menaxhimin financiar të projekteve, përgatitjen e raporteve teknike dhe financiare, menaxhimin e kontratave, komunikimin me partnerët dhe autoritetet financuese, si dhe përdorimin e mjeteve dixhitale për menaxhimin dhe monitorimin e progresit të projektit. Në trajnim përfshihen ushtrime praktike, punë në grupe dhe analiza të rasteve konkrete të projekteve të realizuara në sektorin publik dhe

privat. Në fund të programit, pjesëmarrësit zhvillojnë një projekt final, ku zbatojnë njohuritë e fituara në një propozim konkret.

Trajnimi ndihmon në zhvillimin e aftësive vendimmarrëse, strategjike dhe bashkëpunuese, si dhe në ngritjen e kompetencave për të punuar si menaxher projekti, koordinator, hartues propozimesh, specialist financimi apo konsulent për zhvillimin e projekteve. Në përfundim të trajnimit zhvillohet testimi përkatës referuar moduleve të zhvilluara, dhe pjesëmarrësit pajisen me certifikim të njohur nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve në Republikën e Shqipërisë.

PRIORITETET NË TË ARDHMEN

Në përputhje dhe në zbatim të *“Strategjisë Institucionale të Zhvillimit 2025–2032”*, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, ka përcaktuar si një nga prioritetet kryesore të tij zhvillimin e programeve të trajnimit profesional dhe edukimit në vazhdim, me qëllim përgatitjen e specialistëve bashkëkohorë të aftë për të përballuar sfidat e tregut të punës dhe transformimet e shoqërisë digjitale. Universiteti synon të krijojë një platformë të qëndrueshme të formimit profesional, ku ndërthuren njohuritë akademike me praktikat më të mira të zhvillimit ekonomik, teknologjik dhe mjedisor, duke kontribuar në modernizimin e ekonomisë kombëtare dhe në rritjen e konkurrueshmërisë së burimeve njerëzore në tregun europian. Në këtë kontekst, Institucioni ynë i ka orientuar politikat e tij të zhvillimit drejt inovacionit dhe dixhitalizimit, duke u fokusuar në fushat që përfaqësojnë prioritetet e dekadës së ardhshme. Teknologjia dhe profesionet e reja janë në qendër të vizionit të universitetit, me synimin për të zhvilluar programe në fusha si siguria kibernetike, inteligjenca artificiale, analiza e të dhënave, zhvillimi i softuerit, FinTech dhe sistemet e pagesave digjitale, që do të përgatisin profesionistë të aftë për të drejtuar proceset e inovacionit dhe transformimit digjital në sektorët publik dhe privat.

Një tjetër drejtim strategjik është orientimi drejt ekonomisë së gjelbër dhe zhvillimit të qëndrueshëm, me synim krijimin e trajnimeve profesionale në fushat e energjisë së rinovueshme, menaxhimit të burimeve natyrore etj.. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë gjithashtu synon të forcojë kapacitetet profesionale në menaxhimin e projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare, duke ofruar trajnime që zhvillojnë aftësi për hartimin, planifikimin dhe implementimin e projekteve zhvillimore, financuar nga fondet e Bashkimit Evropian dhe organizatat ndërkombëtare. Përmes këtyre programeve, universiteti synon të krijojë një kulturë të re bashkëpunimi akademik dhe institucional që nxit integrimin e Shqipërisë në rrjetet evropiane të zhvillimit dhe inovacionit. Një pjesë e rëndësishme e vizionit për të ardhmen mbetet edhe përmirësimi i etikës profesionale, qeverisjes së mirë dhe transparencës institucionale përmes programeve të edukimit në vazhdim që promovojnë integritetin, përgjegjshmërinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm shoqëror. Krahas kësaj, universiteti do të vazhdojë të investojë në trajnimet për sektorin e shëndetit dhe kujdesit social, me fokus në shëndetin mendor, burnout-in profesional dhe inovacionin teknologjik në shërbimet mjekësore dhe sociale. Në tërësi, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë synon të krijojë një mjedis të integruar të formimit profesional dhe edukimit të vazhduar, që bashkon akademinë, tregun e punës dhe shoqërinë. Përmes bashkëpunimeve me institucione kombëtare e ndërkombëtare, partnerë të biznesit dhe qendra kërkimore, Institucioni ynë do të zgjerojë në mënyrë të qëndrueshme ofertën e trajnimeve dhe certifikimeve profesionale, duke kontribuar në aftësimin e brezave të rinj të profesionistëve të orientuar drejt inovacionit, dijes dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Prof.Asoc.Dr. Edit BREGU

PROREKTOR dhe Drejtore e Kualifikimit Profesional